



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR  
KANCELARI**

Nr. 960 Prot.

Tiranë, më 13.11.2023

**Lënda:** *Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor, në kategorinë ekzekutive Specialist Protokolli.*

**KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*Godina "Poli i Drejtësisë", Rruga "Ana Komnena",*

**TIRANË**

Në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", nenit 28, të Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", në përfundim të verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor dhe kërkesave të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim, ju njoftojmë se për:

- **1 (një) vend vakant në pozicionin Specialist Protokolli, kategoria ekzekutive, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar,**

janë paraqitur 2 (dy) kandidatura, të cilët plotësojnë kushtet e përgjithshme:

- 1. Bledar Hoxhaj**
- 2. Elton Sulollari**

Në lidhje me kriteret e veçanta (kushtet e sigurisë që duhet të plotësojnë kandidatët përpara se të caktohen apo punësohen në këtë pozicion, sipas nenit 6 të ligjit nr. 95/2016), për të vazhduar më tej në fazën e vlerësimit profesional sipas nenit 32 të Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 të KLGJ, pritet Raporti nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës.

*Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin!*



**KANCELARI**

**Elka Dajçi**